



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**

Në mbështetje të Rregullores së MF. nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ, Vendimin nr. 4 të datës 18/1/2024 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë për thirrjen publike për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, Vendimit nr. 18 të datës 6/2/2024 të Sekretares të Përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë për themelimin e komisionit vlerësues për përzgjedhjen e projekteve për mbështetje financiare publike të OJQ-ve, Komisioni vlerësues nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **APROVOHEN** kërkesat e OJQ-ve sipas thirrjes publike të datës 16/4/2024 të Ministrisë së Drejtësisë për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare (si më poshtë nga nr. 1-12):
1. Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindor – OFAP- Prishtinë;
  2. Fondacioni Terre Des Hommes Lausanne në Kosovë;
  3. Kosova Humanitarian and Charitable Society – Mother Theresa - Prishtinë
  4. Shoqata për Kujdesin Shtëpiak të të Smuarëve – Duarte Plotë Mëshirë - Pejë;
  5. Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara – Handikos Ferizaj
  6. Shoqata për Rehabilitimin e Personave me Nevoja të Veçanta – Suharekë;
  7. Shoqata e të Verbërve të Kosovës – Prishtinë;
  8. Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Gjakovës – Handikos – Gjakovë;
  9. Shoqata e Fëmijëve dhe të Rriturëve me Aftësi të Kufizuara Handikos – Vushtrri;
  10. Qendra Kosovare për Vetë-Përkrahje – QKVP – Prishtinë;
  11. Qendra për Përkrahje të Personave me Aftësi të Kufizuara Mentale – Qendra për Jetë të Pavarur - Pejë
  12. Shoqata Humanitare e Prindërve me Persona me Aftësi të Kufizuara Mendore “Hadër”, Prizren.
- II. **REFUZOHEN** kërkesat e OJQ-ve sipas thirrjes publike të datës 16/4/2024 të Ministrisë së Drejtësisë për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare (si më poshtë nga nr. 1-2):

1. Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Gjilanit - Handikos Gjilan;
2. Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara të Mitrovicës, Hanidkos - Mitrovica.

### Arsyetim

OJQ-të sipas pikës I të këtij vendimi kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë përkitazi me thirrjen publike të Ministrisë së Drejtësisë dhe kanë plotësuar të gjitha kriteret e parapara me këtë thirrje dhe Rregulloren përkatëse, andaj Komisioni ka vendosur për financimin e projekteve të propozuara.

Ndërkaq, sa i përket OJQ-ve nga pika II e këtij vendimi, respektivisht, Shoqatës së Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Gjilanit - Handikos Gjilan dhe Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara të Mitrovicës, Hanidkos - Mitrovica, nuk kanë përmbushur pikën 10 të thirrjes publike ku thuhet: *Periudha e zbatimit të projektit është 12 muaj.*

**Këshilla juridike:** OJQ-të e pakënaqura me këtë Vendim mund të parashtrajnë ankesë me shkrim në Komisionin e Ankesave në Ministrinë e Drejtësisë, në afat prej 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij Vendimi në ueb-faqen e MD-së.

Komisioni vlerësues:

Skender Jahaj

Ilir Mazreku

Fjolla Sojeva

Fehmi Ibrahim

Almedine Jaha